

VENDIM
Nr. 593, datë 15.10.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA E ARBRIT’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 794 datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rruga e Arbrit’, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 6 244 373 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekësh ...” zëvendësohet me “... 6 998 021 (gjashtë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzet e një) lekë ...”.

b) Pas pikës 4.1 shtohet pika 4.2, me këtë përmbajtje:

“4.2 Vlera shtesë e shpronësimit, prej 753 648 (shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi i shtohet edhe tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN, “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 794, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ‘NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA E ARBËRIT’”, TË NDRYSHUAR

Nr.	Pronari			Të dhëna (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit			Vlera totale (lekë)	Shënime	Adresa
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sip. e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)			
1	Said	Ramazan	Canaj	1263	728/3	Arë	3020	586	448	262,528.0	262,528.0		Tiranë, Brar
	Astrit	Said	Canaj										
	Durim	Said	Canaj										
2	Kujtim	Osman	Sinani	3444	5/75.	Arë	715	140	100	14,000.0	14,000.0		Bukqizë
3	Ylber	Selman	Hoxha	1171	515	Arë	4259	147	448	65,856.0	65,856.0		Tiranë Besh
	Arben	Selman	Hoxha										
	Aishe	Ylber	Hoxha										
	Melisa	Ylber	Hoxha										
4	Ylber	Selman	Hoxha	1171	507/1	Arë	1461	918	448	411,264.0	411,264.0		Tiranë Besh
	Arben	Selman	Hoxha										
	Aishe	Ylber	Hoxha										
	Melisa	Ylber	Hoxha										
Vlera totale											753,648.0		